

## XHEVAT LLOSHI

## MBI DISA REZULTATE KRYESORE NË STUDIMIN E LEKSİKUT DHE TË FORMIMIT TË FJALËVE NË GJUHËN SHQIPE PAS ÇLIRIMIT

Puna, që lulëzoi me mundin e Rilindasve dhe vazhdoi më tej në hullinë e tyre, për të nxjerrë në dritë visarin leksikor të shqipes, për ta pastruar atë dhe për ta pasuruar e përsosur, ka qenë edhe hapi i parë i rëndësishëm për leksikologjinë e gjuhës shqipe. Kjo veprimtari, e drejtuar nga qëllime kombëtare e patriotike, duke bërë të njohur pasurinë e mjeteve të shqipes dhe të mundësive të tyre për zhvillim, krijoi njëkohësisht edhe premisat e domosdoshme për të kaluar më vonë në studimin e përgjithësimin teorik. Përveç kësaj, edhe zgjidhja e detyrave praktike në një mënyrë ose në një tjetër ishte e lidhur me një vështrim përgjithësues të çështjeve. Kështu p.sh. leksikografi i shquar K. Kristoforidhi, me zgjidhjet e arritura në hartimin e «Fjalorit të gjuhës shqipe» dëshmon për një përpunim mjaft të thellë të një vargu çështjesh, të cilat lidhen drejtpërdrejt me teorinë leksikologjike.

Në periudhën deri në prag të çlirimit ndeshemi në tekstet shkollore dhe në shtypin e kohës me shënime të ndryshme për sinoniminë e antoniminë, për neologjizmat e frazeologjinë. Gjithashtu ka mjaft vërejtje e mendime për fjalët e kuptimet në rasat e diskutimeve për fjalët e reja të panjohura, për fjalorët e ndryshëm të botuar, për terminologjinë dhe fjalët e reja të krijuara në fusha të ndryshme. Megjithatë nuk mund të bëjmë fjalë para çlirimit për leksikologjinë si një disiplinë shkencore më vete, me një teori të plotë e të përpunuar.

Gjuhësia e huaj për shqipen, duke u nisur kryesisht nga kërkesat e studimeve krahasuese-historike, kërkesa të cilat disa herë lidheshin edhe me qëllime politike të caktuara, i ka rrahur gjërësisht problemet e leksikut dhe të semantikës pothuaj vetëm në prizmin historik. Prandaj leksikologjia dhe semasiologjia historike kanë lënë një trashëgim jo të pakët. Megjithatë edhe kjo trashëgimi e periudhës para çlirimit na del sot me disa të meta e zbrastësi, të cilat na detyrojnë ta shohim me sy kritik. Nga këto të meta duhen përmendur dy me rëndësi, E para, ajo mbështetje mbi një metodologji dhe konceptim filozofik, të huaja për botëkuptimin materialist, sidomos në çështjen themelore të semasiologjisë: marrëdhënjet ndërmjet nocionit, kuptimit të fjalës dhe sendeve e dukurive të botës objektive, pasi i ka mënjanuar faktorët shoqërorë. E dyta, në këtë trashëgimi mbizotëroi studimi i fjalëve të veçanta dhe i lidhjeve të jashtme historike me gjuhët e tjera indoevropiane, duke mos e vështruar gjithnjë leksikon e shqipes si një sistem me rrugët dhe ligjet e veta të brendshme të zhvillimit historik.

Prandaj mund të themi se leksikologjia shqipe, si dega që ka për detyrë themelore përshkrimin shkencor të sistemit leksikor të shqipes dhe sqari-

min e ligjeve historike të zhvillimit të tij, u veçua në gjuhësinë tonë pas çlirimit dhe ka bërë përpara për të arritur një varg rezultatesh, të cilat duhen vënë në dukje më hollësisht.

Në vitet e para pas çlirimit detyrat më të ngutshme ju shtruan leksikografisë,<sup>1</sup> e cila duhej t'i përgjigjej kërkesës që shtronin të gjitha fushat e jetës së re për një fjalor shpjegues të shqipes. Në rrethanat e reja të punës me një kolektiv autorësh dhe për të qenë në nivelin shkencor që e lyppte koha, hartimi i fjalorit nuk mund të mbetej një punë thjesht praktike. Prandaj që në këto hapa u ndje nevoja e rrahjes së çështjeve, e studimit të leksikut, për ta paraqitur pastaj atë në mënyrë sa më të plotë e shkencore në fjalor. Dy diskutime të gjëra, të cilat dëshmonin njëkohësisht se gjuhësia jonë në përgjithësi po ngrihej në një nivel të ri teorik, shërbyen si shtysa edhe për gjallërimin e mendimit në fushën e leksikologjisë.

Diskutimi i parë u zhvillua për çështjet e marksizmit në gjuhësi,<sup>2</sup> pas daljes së veprës së njohur të J.V.Stalinit.

Rëndësia e këtij diskutimi për leksikologjinë e leksikografinë ishte se aty u theksua, që leksiku është një pjesë përbërëse e themelore e strukturës së gjuhës, studimi dhe njohja e të cilit është po ashtu ndër detyrat kryesore të gjuhësisë. Kështu krahas gramatikës, e cila kishte qenë dega mbizotëruese e përkrahimit të shqipes së gjallë, u rendit edhe teoria mbi leksikun e saj në gjendjen e sotme. Diskutimi rrahu edhe disa nga çështjet e fondit themelor të fjalorit.

Diskutimi i dytë që mbi gjuhën letrare kombëtare.<sup>3</sup> Në të u theksua roli i leksikut në kristalizimin e gjuhës letrare.<sup>4</sup> Në lidhje me këtë rol, dolën edhe disa detyra të ngutshme si për leksikologjinë, dhe për leksikografinë. Para së gjithash, u pa në një prizëm të ri kërkesa për zgjerimin e kërkimeve leksikore në terren. Mbledhja e materialeve të reja nga gjuha e popullit u pa jo thjesht si nevojë e studimeve gjuhësore, por si punë me rëndësi për një pasuri kulturore me vlerë kombëtare: për gjuhën letrare. Veç kësaj, për studimet u shtrua, nga njëra anë, nevoja e studimit të lëvizjeve, që janë bërë në shtresat e ndryshme të leksikut, të para në lidhje të ngushtë me procesin e formimit të gjuhës letrare; nga ana tjetër, nevoja e studimit të rrugëve e të mjeteve kryesore për pasurimin e leksikut. Me vlerë është se kështu zuri një vend të përhershëm studimi i leksikut, i ndërthurur me detyrat e gjuhës letrare. Para çlirimit nuk ishte shtruar problemi i leksikut në prizmin e normës letrare, nuk ishte parë mundësia e rivlerësimit të mjeteve leksikore në nivelin gjithëkombëtar, si pasuri e gjuhës letrare të përbashkët.

Një shtysë të re, por nga një drejtim tjetër, i dha leksikologjisë botimi i «Fjalorit të gjuhës shqipe» më 1954. Fjalori shpjegues nuk është vetëm një vepër leksikografike, ai është edhe një vepër e çmueshme leksikologjike, pasi jo vetëm pasqyron mishërimin praktik të koncepteve mbi leksikun e gjuhës, por edhe shërben si bazë për përkrahimin sistemor dhe studimin përgjithësues të leksikut. Kjo është arsyeja, përse punimet e mëvonshme leksikologjike i janë drejtuar materialit të tij,

1) A. Xhuvani, *Referat në mbledhjen për krijimin e Institutit të studimeve*, «Buletin i Institutit të studimeve», 1947, f. 32-34.

2) Shih materialet në «Buletin për shkencat shoqërore», 1952, nr. 1.

3) Shih materialet në «Buletin për shkencat shoqërore», 1952, nr. 4.

4) M. Domi, *Rreth fondit kryesor të fjalëve e fjalorit të shqipes*, «Buletin për shkencat shoqërore», 1952, nr: 4, f 102-107:

kanë shqyrtuar nga afër zgjidhjet e arritura për çështjet e ndryshme dhe janë mbështetur në to për thellimin e mëtejshëm. Gjallëria e studimeve leksikologjike e leksikografike në periudhën e mëpasme nuk mund të kuptohet e shkëputur nga dalja në dritë e këtij fjalori.

«Fjalori i gjuhës shqipe» shërbeu njëkohësisht edhe si një cak i qartë, deri ku kishin ecur leksikologjia e leksikografia jonë. Kjo që një vepër, përfundimi i së cilës i bënte studjuesit t'i shihnin më kthjellët detyrat e së ardhshmes. Nuk është e rastit prandaj, që artikujt rreth tij<sup>5</sup> e vështronin jo si një punë të veçantë, por si një etapë në zgjidhjen e një detyre të madhe e të rëndësishme për gjuhësinë tonë. Artikujt e botuar dëshmuuan gjithashtu se nuk mund të bëhej një hap cilësor në leksikografi pa studimin e leksikut të shqipes së sotme, domethënë pa një teori leksikologjike e leksikografike të përpunuar. A. Kostallari në artikullin «*Në rrugën e hartimit të fjalorit normativ të shqipes së sotme*», duke u përqëndruar në parimet shkencore të kësaj dege të gjuhësisë, i formulonte kështu detyrat që dilnin: «Për fjalorin normativ të shqipes së sotme nevojitet pa tjetër një bazë e shëndoshë teorike. Një bazë e tillë do të jenë punimet përshkronjëse në lidhje me strukturën e leksikut të gjuhës sonë të sotme dhe ligjet e zhvillimit të tij, studimi i marrëdhënjeve të gjalla të leksikut me fondin kryesor të fjalëve në lëmin e formimit të fjalëve, studimi i shkallës së përdorimit të shtresave të ndryshme leksikore, i tendencave të zhvillimit të tyre dhe i kuptimeve të ndryshme»<sup>6</sup>.

Duke vështruar drejtimin që morën studimet, na del si rezultat i përgjithshëm se vëmendja kryesore kaloi nga aspekti historik në studimin e leksikut të sotëm, të gjuhës së gjallë shqipe. Leksikologjia e gjuhës së sotme shqipe përbën thelbin e leksikologjisë shqipe dhe vështrimi historik ndihmon për të kuptuar këtë gjendje të sotme, rrugën që ka sjellë deri këtu dhe ligjet e rregullësitë e ndryshimeve e të zhvillimit të mëtejshëm. Kështu u hap rruga për studimin në plan të gjerë dhe nga të gjitha anët të leksikut të shqipes së sotme.

Artikujt, studimet e punimet e botuara, gjatë kësaj periudhe, të cilat trajtojnë çështjet e leksikologjisë shqipe, janë të shumta, prandaj mund të ndalemi kryesisht në konceptet themelore, që janë zhvilluar e kanë zënë vend në këtë fushë.

Sot ne shohim se tashmë është kapërcyer trajtimi i njësive të veçuara të fjalorit dhe studjuesit e shohin thesarin e fjalëve të shqipes si një sistem, natyrisht mjaft të lëvizshëm e të ndërlikuar, porse me një vështrim të tillë janë rrokur më mirë veçoritë e tij. Ky konceptim i leksikut si sistem është bërë i përgjithshëm dhe mbi bazën e tij u bë e mundur të ndërtoheshin parimet për hartimin e fjalorit të gjuhës së sotme shqipe. Në këto parime, fjalët i janë nënshtuar një analize tërësore nga disa drejtime, kështu që në fjalorin e ardhshëm ato do të hyjnë jo si njësi të veçuara, të renditura alfabetikisht, por si njësi që zënë

5) A. Kostallari, *Në rrugën e hartimit të fjalorit normativ të shqipes së sotme*, «Buletin për shkencat shoqërore», 1955, nr. 4, f. 17-56; A. Xhuvani, *Çështja e Fjalorit të gjuhës shqipe*, «Nëndori», 1957, nr. 1, O. Myderrizi, *Rreth ripunimit të «Fjalorit të gjuhës shqipe»* «Buletin për shkencat shoqërore», 1957, nr. 2, f. 204-221; F. Ndocaj, *Veçantia e gjuhës dhe fjalori i Institutit të shkencave 1954*, «BUSHT, Seria shkenc. shoq.» 1958, nr. 2; 1961, nr. 1,2; P. Geci, *Pasunia e leksikut të shqipes dhe fjalorit i gjuhës shqipe. Disa vërejtje rreth fjalorit*, «BUSHT, Seria shkenc. shoq.» 1959, nr. 1, f. 157-162.

6) A. Kostallari, *Në rrugën e hartimit....*, f. 49-50.

një vend të caktuar në një sistem, vend që përcaktohet «sipas vlerës objektive në strukturën leksikore të shqipes së sotme letrare».<sup>7</sup>

Pa këtë konceptim vetë leksikologjia e gjuhës së sotme do të humbiste objektin e saj si disiplinë gjuhësore. Një përpjekje të parë për ta ndjekur këtë koncept në çështjet kryesore e kemi në dispensën «Leksikologjia shqipe»<sup>8</sup>, hartuar për nevojat e studentëve të gjuhës shqipe. Vetë përfshirja e kësaj lënde në programet universitare dhe hartimi i tekstit për të dëshmojnë, se leksikologjia tashmë kishte zënë vendin e vet në gjuhësinë shqiptare.

Në përgjithësi vihet re se horizonti i vështrimit është zgjeruar, janë përfshirë në studim fusha dhe materiale të reja. Veç kësaj, ky ndryshim sasior është shoqëruar me një thellim të trajtimit e që të dyja janë kushtëzuar nga një koncept i ri mbi pasurinë leksikore të shqipes.

Për shumë kohë si pasuri e vetme ishte parë njësia themelore e leksikut-fjala. Hera-herës kishin tërhequr vëmendjen edhe disa lokucione, shprehje ose mënyra të thëni, që dukeshin interesante e specifike, ishte bërë e zakonshme të flitej për «varfërinë» e fjalorit të shqipes, sepse të varfëra ishin njohuritë mbi leksikun e shqipes dhe i mangët ishte vetë koncepti mbi pasurinë e tij. E ashtuquajtura «varfëri» mbështetej pra në numërimin mekanik të fjalëve që njiheshin, duke i mbyllur sytë përpara veçorive të shqipes.<sup>9</sup> Teoria jonë e sotme e sheh visarin leksikor të shqipes jo vetëm në fjalët, por edhe në kuptimet, përdorimet, nuancat e ngjyrimet, në frazeologjinë e pashterrshme, në togjet e tipave të ndryshëm, në mundësitë e lidhjeve, e kombinimeve e të shtresimeve të ndryshme, në mjetet e fjalëformimit dhe të strukturave e të modeleve të tyre.

Ky koncept mbi pasurinë leksikore, siç u tha më lart, e zgjeroi horizontin e vështrimit dhe e thelloi trajtimin. Për të depërtuar në këtë pasuri u bë e domosdoshme të shihej fjala në jetën e saj të gjallë, në të gjithë larinë e përdorimit. Me këtë gjeti vend edhe nocioni mbi kontekstin e fjalës e mbi lidhjet sintagmatike si çështje leksikologjike. Gjithashtu disa veçori analitike të strukturës së shqipes u lidhën me anën leksikore dhe si gjithnjë, materiali i ri kërkoi edhe diskutimin e metodikës së studimit të tij<sup>10</sup>. Këto ndryshime në teori, patën pasojë në drejtimin tjetër, që morën kërkimet dhe mbledhja praktike e leksikut. Më parë vëmendjen e kishin tërhequr kryesisht fjalët e rralla, të reja e të panjohura, kurse për fjalët «e zakonshme» mendohej se njiheshin mirë.\* Tashti duket shkoqur se sa punë mbetet për të bërë edhe për fjalët «e njohura», sa kuptime, nuanca, frazeologji ose përdorime mbeten ende për t'u mbledhur nga goja e popullit dhe nga literatura e shkruar.

Në mënyrë të pashmangshme ndryshoi edhe koncepti mbi rrugët e pasurimit të leksikut të shqipes. Huazimet kanë qenë objekti i përherëshëm i vëmendjes në këtë drejtim. Nga ana tjetër, një nocion tepër i

7) A. Kostallari, *Parimet themelore për hartimin e «Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe»*, «Studime filologjike», 1968, nr 2, f. 59.

8) J. Stefi, *Leksikologjia shqipe*, Tiranë, 1961.

9) Kështu bëhej një ballafaqim mbi baza të gabuara i shqipes me gjuhët e tjera në rastet e përkthimeve, jehonën e të cilit e ndeshim deri vonë. «Vobesia e fjalorit shqip na detyron të humbasim shumë njomëshiti ndjenjash e nuanca idesh dhe të përdorim perifrizat, që e largojnë përkthimin nga teksti». O. Myderrizi, *Rreth ripunimit...*, f. 209.

10) Xh. Lloshi, *Shënime për fjalën dhe togfjalëshin*, «Studime filologjike», 1966, nr. 4, f. 185-201.

\*) A. Xhuvani *Fjalë të pambledhuna*, «Buletin i Institutit të shkencave», 1948, nr. 1, f. 55.

zgjëruar mbi neologjizmat mbulonte pothuajse gjithë rrugët e tjera të pasurimit, prandaj nuk kuptohej drejt çështje fjalëformimi. Edhe përfshirja në përdorim gjithëkombëtar e fjalëve nga burimet e ndryshme të shqipes nuk shihej nga pozitat e teorisë, megjithëse ishte dukuri e ditës. Leksikologjia jonë e sotme ka treguar qartë se formimi i fjalëve me brumin e gjuhës amëtare përbën rrugën kryesore të pasurimit. Të rëndësishme janë edhe rrugët e tjera të brendshme: përhapja në përdorim të përgjithshëm e fjalëve nga gjuha e gjallë e popullit, zhvillimi kuptimor i fjalëve; lindja e ngjyimeve dhe e nuancave të reja, diferencimi sinonimik, krijimi i njësive frazeologjike e i togjeve të qëndrueshme, zgjerimi i aftësive të fjalës për lidhje të reja.

Koncepti i ri mbi visarin e leksikut të shqipes dhe rrugët e pasurimit të mëtejshëm ka gjetur formulimin e plotë në «Parimet themelore për hartimin e «Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe». Kjo do të thotë se përparimi teorik ka patur pasojë të drejtpërdrejta edhe në praktikë, duke ndihmuar sidomos në procesin e normalizimit të gjuhës letrare. Puna për kulturën e gjuhës dhe për pastërtinë nuk ngushtohet më në fjalën si njësi mekanike. Për përpjekjet, që gjuha në fushat e ndryshme të veprimtarisë shoqërore-politike ose në letërsi të bëhet sa më e larme e shprehëse, hapen mundësi të mëdha. Meriton të përmendet në veçanti vepra e A. Xhuvanit «Për pastërtinë e gjuhës shqipe» (1956), ku këto mundësi janë shfrytëzuar në një material të gjërë konkret.

Është e domosdoshme të vihet në dukje se fjalët dhe shtresat leksikore janë vështruar të lidhura me kushtet historiko-shoqërore, që kanë përcaktuar ndryshimet dhe zhvillimin e tyre. Me këtë ka gjetur zbatimin konkret mendimi i njohur, që leksiku lidhet më ngushtë me jetën dhe u përgjigjet më drejtpërdrejt lëvizjeve e kërkesave të saj. Prandaj janë nxjerrë në plan të parë lidhjet me çështjet e ideologjisë e të politikës, ndikimi i kushteve shoqërore, ekonomike e kulturele dhe i klasave shoqërore mbi leksikun; edhe vetë pasurimi i leksikut është parë në vartësi nga këto kushte. Posaçërisht janë vëzhguar ndryshimet e ndjeshme në leksik, që kanë ngjarë pas revolucionit popullor, si pasojë e ndryshimeve të mëdha që sollin ai në të gjithë jetën e vendit. Përveç vëzhgimeve e përfundimeve të përgjithshme që janë dhënë në disa punime të A. Kostallarit, kohët e fundit janë ndërmarrë punime për ndryshimet në sfera të veçanta, si p.sh. në leksikun politik-shoqëror, në emërtimet e njerëzve sipas profesionit etj. Megjithatë kjo anë pret një studim edhe më të thellë e të gjithanshëm.

Nga pikëpamja thjesht leksikologjike, përpara studjuesve ka qenë dhe vazhdon të mbetet si detyrë e përhershme nxjerrja në pah e veçorive të fjalës shqipe, e specifikës së saj. Në zgjidhjen e kësaj detyre studimi nuk ka hyrë në rrugën e verbër të vështrimit formalist, por forma është parë gjithnjë në lidhje të ngushtë me përmbajtjen. Kjo ka bërë që kuptimi i fjalës të ndriçohet në anë të ndryshme dhe prandaj semantika zë një vend të dukshëm në të gjithë argumentimin. Kështu zbërthimi semantik i fjalëve të përbëra në gjuhën shqipe, i arritur në punimet e A. Kostallarit<sup>11</sup> ka ndihmuar për të zbuluar veçoritë theme-

11) A. Kostallari. *Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe*, «BUSHT. Seria shkencat shoqërore», 1961, nr. 3, f. 3-20; *Kompozitat ekzocentrike të shqipes si tema fjalëformuese*, «BUSHT, Seria shkencat shoqërore», 1962, nr. 3, f. 3-45; *Mbi disa veçori të strukturës semantike të kompozitave pronësore të shqipes*, «Konferenca e parë e studimeve albanologjike», T. 1965, f. 161-167; *Kompozitat dëshirore dhe urdhërore të shqipes*, «Studime filologjike», 1968, nr. 4, f. 23-64.

lore të fjalës së përbërë shqipe. Rezultat i rëndësishëm është kalimi nga vështrimi i kuptimit të fjalës ashtu siç kërkohet nga fjalorët e mëparshëm, tek koncepti mbi fjalën si strukturë kuptimesh, pra mbi strukturën semantike të fjalës. Kjo kërkoi studimin e kuptimeve dhe të përdorimeve, dallimin e kuptimeve të para nga të prejardhurat e të figurshmet, zbrëthimin e rrugëve të ndryshimit të kuptimeve etj. Nga një detyrë e shtruar,<sup>12</sup> ky studim shkoi më tej në disa punime, si p.sh. në dispensën «Leksikologjia shqipe», në artikullin e veçantë të J. Thomajt «Mbi mënyrën e pasqyrit të sistemit të kuptimeve dhe përdorimeve të fjalëve në fjalorin shpjegues të gjuhës shqipe»<sup>13</sup> e gjetkë.<sup>14</sup>

Kështu mori rrugë trajtimi i polisemisë në gjuhën e sotme shqipe dhe u bë e mundur të arrihej në një zgjidhje tërësore për problemin e zbrëthimit e të shpjegimit të kuptimeve të fjalëve në fjalorin e ardhshëm të gjuhës së sotme.<sup>15</sup> Tashmë ka mundësi të kalohet nga vëzhgimet e përgjithshme në trajtimin e hollësishëm të polisemisë së fjalës shqipe, që del aq e gjërë dhe e pasur me kuptime, aq e zhdërvjellët në përdorim dhe me aq mundësi të brendshme për t'u shtjelluar më tej.

Në lidhje me problemet e polisemisë janë rrahur edhe çështjet e homonimisë leksikore, të vendit e të ndikimit të saj në gjuhë<sup>16</sup>.

Duke e vështruar leksikun si sistem, leksikologjia jonë megjithatë nuk e ka lënë mënjatë fjalën si njësi themelore, por përkundrazi, e ka vënë atë në qendër të vëmendjes dhe e ka parë në të gjitha lidhjet e aspektet. Nga shumë drejtime gjuhësia jonë në përgjithësi i është afruar më ngjat përpunimit të nocionit teorik mbi fjalën shqipe si njësi. Problemi i fjalës në literaturën gjuhësore para çlirimit ka gjetur pothuaj kurdoherë një zgjidhje empirike. Si në fjalorët, edhe në gramatikat e artikujt vihej re një ngatërrim i fjalës me trajtat e saj, i fjalës me variantet. Po ashtu nuk ishte i qartë dallimi ndërmjet fjalës së përbërë dhe togfjalëshit, midis fjalës e frazeologjisë; vështirësitë kapërceheshin ose mbuloheshin me terma jo të përpikta. Në disa raste zgjidhjet janë marrë të gatshme, gjë që ka çuar dhe në pranimin e teorive jo të drejta.<sup>17</sup>

Në ditët tona gramatika, leksikologjia dhe teoria e fjalëformimit po e përpunojnë këtë çështje, duke u mbeshetur në tezën mbi fjalën si njësi leksiko-gramatikore, duke e parë si unitet të formës dhe të kuptimit, të anës gjuhësore dhe të rezultateve të njohjes e të mendimit. Ndonëse nuk është arritur një zgjidhje plotësisht e kënaqshme, pasi mungon p.sh. përcaktimi i plotë i pjesëve të ligjëratës në shqipen dhe jo të gjitha pjesët janë studjuar nga prizmi i këtij uniteti, përsëri përfundimet e arritura janë me vlerë si për teorinë e degëve të ndryshme të gjuhësisë, ashtu edhe për praktikën e hartimit të fjalorëve (lidhur me çështjet e trajtës përfaqësuese, të homonimisë, të frazeologjisë etj.) dhe për saktësimin e rregullave të drejtshkrimit.

12) A. Kostallari, *Në rrugën e hartimit...*, f. 39-40.

13) J. Thomaj, *Mbi mënyrën e pasqyrit të sistemit të kuptimeve dhe përdorimeve të fjalëve në fjalorin e gjuhës shqipe* «Studime filologjike», 1964, nr. 4, f. 203-214.

14) Xh. Lloshi, *Shënime për fjalën...*, f. 191-192.

15) A. Kostallari, *Parimet themelore...*, f. 99-102.

16) Xh. Lloshi, *Vëzhgime mbi homoniminë në gjuhën shqipe*, «Studime filologjike», 1964, nr. 2, f. 45-64; Xh. Lloshi, *Rreth disa shfaqjeve të ndikimit të homonimisë në gjuhën shqipe*, «Studime filologjike», nr. 3, f. 125-130.

17) Kështu p.sh. është shkencërisht i gabuar mendimi sipas të cilit «çdo kuptim është një fjalë më vehte, por na për arësye praktike i vemë të gjitha kuptimet nën një fjalë të vetme» P. Geci *Pasunia e leksikut të shqipes...* f. 161

Ndër grupimet semantike të fjalëve janë rrahur më gjërësisht antonimet në disa artikuj të M. Samarës.<sup>18</sup> Theksi është vënë mbi karakterin antonimik të kuptimeve, ndonëse ende nuk është sqaruar deri në fund ndryshimi midis antonimisë dhe mohimit.

Nëpër punimet e ndryshme ka mjaft vërejtje për sinoniminë, mi-rëpo mungesa e studimit të gjithanshëm të sinonimisë është një zbrastësi e ndjeshme. Arësyet e kësaj mungese janë, nga njëra anë karakteri i ndërlikuar i vetë çështjes, lidhur edhe me veçoritë e fjalës shqipe e të formimit të gjuhës letrare, nga ana tjetër, vështirësitë për grumbullimin dhe sistemin e materialit faktik.

Me daljen e fjalorit të ri shpjegues, në të cilin sinonimet do të shërbejnë si mjet plotësues, do të lehtësohet mjaft kapërcimi i këtyre vështirësive.

Ndryshimi i konceptit mbi njësitë e leksikut ka gjetur një shprehje të qartë në punimet mbi frazeologjinë, të ndërmarra nga J. Thomaj.<sup>19</sup> Aty është zbrërthyer me hollësi nocioni mbi frazeologjizmat si njësi leksikore. Janë treguar tiparet thelbësore, marrëdhënjet e brendshme të gjymtyrëve dhe struktura e tyre, duke arritur edhe një klasifikim të përgjithshëm. Lidhur me këtë janë prekur problemet teorike të togfjalëshave të lirë e të qëndrueshëm,<sup>20</sup> duke bërë dallimin e frazeologjizmave prej tyre dhe prej fjalës së veçantë e kompozitave. Në këto punime janë hedhur premisat edhe për të sqaruar strukturën e tyre në vështrimin historik, që të arrihet zbulimi i prejardhjes së tyre; janë dhënë gjithashtu disa krahasime me gjuhët e tjera të Ballkanit.<sup>21</sup>

Lëvrimi i frazeologjisë krahas fushave të tjera do të bëjë të mundshme ndërtimin e një teorie koherente mbi lidhjet semantike të fjalëve në të folur, mbi sintagmatikën semantike. Porse kjo kërkon njëkohësisht edhe sqarimin e lidhjeve semantike paradigmatiche, e grupeve të ndryshme semantike e tematike. Ka disa punime për grupe tematike të caktuara,<sup>22</sup> por më tepër në drejtim historik dhe jo të ndërtuara mbi nocionin e fushës tematike përkatëse. Në ndërthurje me analizën e komponenteve kuptimore të fjalës, këto nocione së bashku do të ndihmonin të zbritet edhe disa shkallë të tjera për të ndriçuar më thellë poliseiminë e shqipes dhe mundësitë e mëdha, që fsheh në vetvete fjala shqipe, mundësi të cilat i shohim të realizuara me një larmi të madhe në jetën e saj të gjallë e që presin të kuptohen e të shpjegohen teorikisht.

Parimet themelore për hartimin e «Fjalorit të gjuhës së sotme», që u botuan pak kohë më parë janë një punim, ku leksikologjia e leksikografia janë shkruirë në një teori të vetme, që jo vetëm përmbledh rezul-

18) M. Samara, *Vëzhgime mbi antonimet me parashitesa në gjuhën shqipe*, «Studime filologjike», 1965, nr. 1, f. 153-162; *Mbi karakterin antonimik të kuptimeve të fjalëve në gjuhën shqipe dhe pasqyrimin e tyre në fjalorin shpjegues*, «Studime filologjike», 1967, nr. 2, f. 21-23; *Mbi antonimet në togfjalësha dhe mbi antoniminë e togfjalëshave të qëndrueshëm në gjuhën shqipe*, «Studime filologjike», 1968, nr. 3, f. 61-66.

19) J. Thomaj, *Probleme të frazeologjisë së gjuhës shqipe*, «Studime filologjike», 1964, nr. 2, f. 69-94; *Mbi rendin e fjalëve në strukturën e frazeologjizmave të shqipes*, «Studime filologjike», 1966, nr. 1, f. 151-161; *Një klasifikim i frazeologjizmave me vlerë ndajfoljore në gjuhën shqipe*, «Studime filologjike», 1969, nr. 1, f. 3-46.

20) Shih edhe: M. Çeliku, *Togfjalësha të qëndrueshëm foljorë në shqipen e sotme*, «BUSHt, Seria Shkencat shoqërore», 1962, nr. 2, f. 194-222 M. Çeliku, *Disa togje foljore në shqipen e sotme*, «BUSHt, Seria shkencat shoqërore», 1963, nr. 1, f. 159-180.

21) J. Thomaj — Xh. Lloshi, *Paralele frazeologjike të shqipes me gjuhë të tjera të Ballkanit*, «Studime filologjike», 1967, nr. 1, f. 97-111

tatet më të rëndësishme, të arritura pas çlirimit në studimet e veçanta, por edhe që i shpie më tej këto rezultate. Prandaj këto parime shënojnë jo vetëm cakun ku ka arritur tashmë mendimi ynë leksikologjik, por edhe i japin shtysa të reja ecjes së tij përpara.

Përveç problemeve, që u prekën më lart, në «Parimet themelore» kanë gjetur një zgjidhje në perspektivë edhe çështjet e shtresave të leksikut. Në veçanti meriton vëmendje shtresimi stilistik i leksikut të shqipës. Nocioni mbi këtë shtresim është formuluar që në diskutimin për «Fjalorin e gjuhës shqipe» të vitit 1954<sup>23</sup> dhe disa nga tiparet thelbësore të shtresave qenë dhënë nga A. Kostallari.<sup>24</sup> Kurse me përgjithësimin e fundit, i cili do të lejojë të pasqyrohen për herë të parë edhe në një fjalor të shqipes veçoritë stilistike të fjalëve,<sup>25</sup> mund të themi se në përpunimin e problemeve të stilistikës gjuhësore leksikologjia ka shkuar më larg se degët e tjera të gjuhësisë shqiptare.

Lidhur me shtresat e leksikut, duhet theksuar se janë ndriçuar më mirë prejardhja, kronologjia dhe karakteristikat e shtresave leksikore, pra plani historik. Për këtë arsye është e nevojshme të ndalemi edhe në zhvillimin e leksikologjisë historike.

Siç u tha më sipër, leksikologjia historike para çlirimit kishte arritur rezultate më të rëndësishme. Në Konferencën e parë të studimeve albanologjike u vu në dukje se prej saj: «U studjuan, u diferencuan dhe u klasifikuan kronologjikisht shtresat që përfaqësojnë në gjuhën shqipe huazime nga gjuhët e tjera, — latinishtja dhe gjuhët romane, greqishtja, gjuhët sllave, turqishtja etj., — dhe u sqaruan rrugët e depërtimit të këtyre huazimeve në shqipen. Mund të themi se ky është drejtimi në të cilin janë arritur rezultatet më të mëdha në albanistikën e derisotme. Kjo lidhet jo vetëm me karakterin historikisht më konkret të materialit leksikor dhe të problemeve që kanë të bëjnë me të, por edhe me faktin se kjo është parë nga albanistika e huaj si detyrë kryesore».<sup>26</sup>

Në këtë periudhë pas çlirimit leksikologjia historike ka arritur rezultate të reja për dy arsye themelore. E para, janë vënë në qarkullim shkencor materiale të reja ose janë paraqitur të përpunuara shkencërisht materiale të njohura më parë, kështu që është zgjeruar baza faktike e studimeve, e cila lot rol vendimtar në studimet historike. Ky material gjendet si në punimet teorike, edhe në punimet paraqitëse me vërejtje kritike.<sup>27</sup> E dyta, janë arritur përgjithësime të reja në vështri-

23) A. Kostallari, *Në rrugën e hartimit...*, f. 48-49.

24) A. Kostallari, *Kompozitat ekzocentrike...*, f. 26-31;

25) A. Kostallari, *Parimet themelore...*, f. 108-117.

26) A. Kostallari, *Gjendja e studimeve albanologjike në Shqipëri. Probleme dhe detyra të reja*. «Konferenca e parë e studimeve albanologjike», T. 1965, f. 26.

27) Sh. Demiraj, *Disa shënime të krahasuara mbi gjuhën e Varibobës*, «Buletin për shkencat shoqërore», 1953, nr. 2, f. 16-31; K. Ashta, *Shënime e vërejtje rreth gjuhës dhe leksikut të Lekë Matrangës*, «Bul. për shk. shoq.», 1957 nr. 1, f. 83-107, Dh. S. Shuteriqi, *Shkrime të Dhaskal Todhrit dhe të pasardhësve të tij elbasanas, shoqëruar me fjalorin e shkrimeve të Todhrit*. «BUSHT, Seria shk. shoq. 1959, nr. 1; T. Dizdari, Nga fjalori «Huazime orientalizmesh në shqipet» «BUSHT, Seria shk. shoq.», 1960, nr. 1. dhe vijim; O. Myderrizi, *Fjalori shqip-turqisht i Ali Ulqinakut*, «BUSHT, Seria shkec. shoq.», 1961, nr. 3. «Studime filologjike», 1965, nr. 3, 4; K. Ashta, *Leksiku i plotë i veprës së Gjon Buzukut* (1955), «Revistë shkencore e Inst Ped. dyvj. të Shkodrës» 1964, nr. 1, vijim; K. Ashta, *Rreth disa çështjeve të leksikut të Pjetër Budit*, «Studime filologjike», 1966, nr. 4, f. 159-165.

min tërësor të shtresave leksikore nga pikëpamja historiko-etimologjike<sup>28</sup> dhe në studimin e veprave të autorëve ose të shtresave të veçanta.<sup>29</sup>

Një punë e madhe gjurmuese në lëmin e historisë e të etimologjive të leksikut të shqipes është bërë nga E. Çabej. Si kurorëzim i saj u bënë të mundura «Studimet rreth etimologjisë së gjuhës shqipe», që filluan të botoheshin në vitin 1960 nga numri 4 i «Buletinit të Universitetit Shtetëror të Tiranës, seria shkencat shoqërore» dhe vijuan deri në numrin 3 të «Studimeve filologjike» të vitit 1968. Vlera e këtyre studimeve i ka llogaritur e etimologjisë ose të leksikologjisë historike. Duke marrë parasysh në radhë të parë lidhjet e brendshme të fjalëve dhe historinë e tyre të brendshme, ju kthyen shqipes mjaft fjalë, që konsideroheshin si huazime. Nga ana tjetër doli në dritë edhe roli dhënës i shqipes. Me këtë u pasurua nocioni mbi huazimet leksikore të shqipes, për shpjegimin e tyre u grumbulluan të dhëna të reja, duke kërkuar ndihmën edhe të degëve e të disiplinave të tjera.

Duke arritur në këtë nivel, leksikologjia historike po përgatitet për të bërë një hap të ri. Fjalori etimologjik i shqipes, që po përfundohet nga E. Çabej, do të jetë një bazë e shëndoshë për kërkimet e ndryshme. Interpretimet e reja dhe materiali i pasur që është grumbulluar do të lejojnë që në një të ardhme jo të largët të shtrohet si detyrë reale hartimi i fjalorit historik të shqipes. Meriton të theksohet veçanërisht një ndryshim cilësor, që po përvijohet në këtë lëmë. Studimet e derisotme kryesisht niseshin nga historia për të kaluar në prehistori dhe i shërbenin më tepër etimologjisë. Ky vështrim kaq i pasur për historinë e leksikut të shqipes megjithatë pak ishte ndihmuar në zgjidhjen e detyrës së shpjegimit të përbërjes së leksikut të shqipes së sotme dhe të gjuhës letrare. Ndërsa tashti po bëhet e mundur e para, të studjohet më mirë vetë leksiku i shekujve të kaluar, duke futur edhe në histori nocionin e sistemit leksikor, për të zbrërthyer ligjshmëritë e zhvillimit historik të shtresave leksikore, e dyta, të ndryshohet kahu për të kaluar nga historia në gjendjen e sotme, për të lidhur diakroninë me sinkroninë. Kjo do të sigurojë që leksikologjia historike t'i shërbejë më mirë kuptimit të proceseve të sotme dhe historisë së gjuhës letrare, që po kristalizohet përfundimisht. Në këtë mënyrë do të kapërcehet një farë shkëputjeje midis leksikologjisë historike dhe asaj të sotme, që ende vihet re.

Me vështrimin historik lidhen edhe disa kategori të veçanta fjalësh si neologjizmat, arkaizmat, historizmat. Siç u prek më lart, nocioni i neologjizmave ka qenë zgjeruar tepër, duke mbuluar gjithë fjalëformimin, pa dalluar krijimet individuale e të rastit, kalkimet e krijimet poetike, fjalët që me të vërtetë ndjehen për një kohë si të reja nga formimet që janë përherë potencë e brendshme dhe që realizohen sapo të dalë nevoja.

Nuk mund të mos vëmë në dukje dy veçori pozitive të të gjitha punimeve në këtë degë. E para, çështjet janë trajtuar gjithnjë duke vënë

28) E. Çabej, *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe*, dispensë, T. 1960; E. Çabej, *Disa probleme themelore të historisë së vjetër të gjuhës shqipe*, «BUSHT, Seria shkencat shoqërore», 1962, nr. 4, f. 117-134; Sh. Demiraj, *Disa shënime rreth lëvrimin të gjuhës shqipe gjatë sh. XIX*, «BUSHT, Seria shkencat shoqërore», 1958, nr. 4, f. 120-133; 1959, nr. 1, f. 49-73; Sh. Demiraj, *Historia e gjuhës së shkruar shqipe*, dispensë, T. 1962.

29) E. Çabej, *Gjon Buzuku*, «Buletin për shkencat shoqërore», 1955, nr. 1-4; Sh. Demiraj, *Gjuha e Sami Frashërit*, «Buletin për shkencat shoqërore», 1955, nr. 3, f. 191-235, J. Gjinari, *Mbi disa elemente sllave në të folmet veriore të Shqipërisë jugore*, «Studime filologjike», 1966, nr. 2, f. 157-167.

në qarkullim një material faktik të ri e të pasur. E dyta, është vlerësuar nga pozita të reja trashëgimia, duke ruajtur kështu edhe vazhdimësinë në zgjidhjet që i kanë qëndruar kritikës.

Struktura kuptimore e fjalës shqipe, lidhjet e saj të ndryshme dhe historia e zhvillimit mund të kuptohen më mirë po të njihet edhe ndërtimi i saj nga pikëpamja e fjalëformimit, për më tepër, formimi i fjalëve të reja është një nga rrugët kryesore të pasurimit të leksikut të sotëm. Prandaj leksikologjia ka ecur në marrëdhënje të ngushta me fjalëformimin.

Para çlirimit, edhe në fushën e studimeve rreth fjalëformimit synohej më tepër për plotësimin e kërkesave të historisë së gjuhës dhe prandaj mbizotëronte analiza etimologjike. Çështjet e fjalëformimit të gjuhës së sotme janë parë edhe në kuadrin e gramatikës e për nevojat e saj, prandaj analiza ishte gjithashtu gramatikore, morfematike. Përppjekje qenë bërë për ta plotësuar inventarin e morfemave fjalëformuese dhe qenë botuar sidomos disa prapashtesa, së bashku me vërejtjet për to.

Rezultati kryesor në këtë lëmë pas çlirimit është përvijimi i fjalëformimit si disiplinë më vete, me objektin, metodën dhe detyrat e veta.

Është jashtë dyshimit, që kanë përparuar më tej edhe analiza etimologjike e morfematike. Kështu në «Studimet rreth etimologjisë së gjuhës shqipe» të E. Çabejt del një kuadër i ri i formimit historik të shumë fjalëve dhe mund të themi se pikërisht analiza e re nga pikëpamja e formimit brenda shqipes ka përcaktuar në shumë raste vetë etimologjitë e reja.

Një përgjithësim i një bilanc kritik i zgjidhjeve të derisotme, së bashku me kontribute të reja e të shumta, me rëndësi për historinë e mjeteve të fjalëformimit të shqipes<sup>30</sup> janë arritur në veprat «Prapashtesat e gjuhës shqipe» dhe «Parashtesat e gjuhës shqipe.»<sup>31</sup>

Në kuadrin e gramatikës së sotme i është kushtuar vëmendje strukturës morfematike të fjalës, janë dhënë tipat kryesorë të fjalëformimit, që lidhen me morfologjinë e sintaksën dhe është shqyrtuar formimi i pjesëve të ndryshme të ligjëratës.<sup>32</sup> Për ndajfoljet është botuar edhe një punim i veçantë nga A. Xhuvani, në të cilin formimi i tyre shihet si në planin historik, edhe në të sotmin.<sup>33</sup>

Megjithatë në qendër të vëmendjes është vënë analiza fjalëformuese, që është objekti themelor i kësaj discipline. Kjo ka sjellë që në studimet e ndryshme të zënë vend një varg konceptesh të reja me vlerë.<sup>34</sup>

Para së gjithash, u kalua nga copëtimi mekanik i fjalës në pjesët përbërëse të ideja qendrore mbi strukturën e fjalës si një sistem morfemash, të lidhura e të ndërvarura, të cilat e formojnë fjalën si një të tërë leksiko-gramatikore. Me këtë u hap rruga për të zbuluar veçoritë strukturore të fjalës shqipe. Nga ana tjetër, kjo ide nënkupton medoemos nocionin mbi modelet, tipat e fjalëformimit. Studimi i tyre ka bërë të mund-

30) M. Domi, *Vepër themelore me rëndësi teorike e praktike*, «Zëri i popullit», 9.II.1963, f. 3.

31) A. Xhuvani — E. Çabej, *Parashtesat e gjuhës shqipe*, «Buletin për shkencat shoqërore», 1956, nr. 4, f. 66-103; *Prapashtesat e gjuhës shqipe*, T. 1962.

32) Sh. Demiraj, *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe*, dispensë I, 1961, f. 9-22, 50-52 etj.

33) A. Xhuvani, *Origjina dhe formimi i ndajfoljeve në shqipet*, «Studime gjuhësore», T. 1956, f. 191-199.

34) Shih p.sh. M. Çeliku, *Mbi analizën strukturore të fjalës*, «Arësimi popullor»; 1964, nr. 6.

shme të dallohen disa nga tipat më produktivë e më të gjallë në gjuhën e sotme shqipe, gjë që është me interes të veçantë praktik për gjithë punën në lëmin e terminologjisë, të pastërtisë së gjuhës dhe për plotësimin me kriterë të shëndosha shkencore të kërkesave të mëdha për fjalë të reja, që parashtron jeta e gjallë e sotme në ekonomi, politikë, teknikë, kulturë etj. Përqëndrimi i vëmendjes në tipat e gjallë të shqipes së sotme u jep përpjekjeve për pastërtinë e gjuhës një mbështetje të mirë, pasi u tregon zgjidhjet, që kanë më shumë mundësi të hyjnë në jetë.

Të gjitha këto mund të dëshmojnë më së miri me studimet mbi kompozitat e shqipes. Mosnjohja e materialit të gjallë i kishte shtyrë studjuesit e huaj t'ja mohonin produktivitetin kësaj rruge në shqipen dhe prandaj në krahasim me derivacionin ajo kishte mbetur pothuaj e pastudjuar. Pas çlirimit kompozitat tërhoqën vëmendjen e disa studjuesve,<sup>35</sup> por sidomos janë trajtuar gjerësisht në katër punime të A. Kostallarit.<sup>36</sup> Në këto punime zënë vend të veçantë një varg çështjesh të një rëndësie teorike përgjithësuere. Kështu janë dhënë tiparet thelbësore të fjalës së përbërë, duke dalluar kompozitat e mirëfillta nga fjalët e përngjitura. Nga ana tjetër, duke diskutuar për dallimet e kompozitave nga togfjalëshat dhe fjalët e tjera, është dhënë një kontribut në çështjen e konceptit të përgjithshëm mbi fjalën shqipe. Për fjalëformimin është me vlerë, që për herë të parë u zbatua nocioni mbi temën si pjesë e kompozitave, pasi në punimet e mëparshme mbizotëronte mendimi, se një fjalë e re krijohet nga një ose dy fjalë të tjera dhe jo nga temat përkatëse. Për pasojë, gjeti vend edhe nocioni mbi temën prodhuese.

Kompozitat e shqipes janë parë edhe në planin krahasues, duke nxjerrë tipat e tyre në rrethin e gjuhëve të tjera indoevropiane dhe tiparet themelore e veçoritë e këtyre formimeve në gjuhën shqipe.

Analiza strukturore gjatë studimit është ndërthurur me analizën e veçorive semantike të fjalëve, gjë që ka ndihmuar për zbërthimin e drejtë të përmbajtjes së tyre kuptimore dhe për sqarimin e tipave që përfaqësojnë. Kjo ndërthurje ka dhënë rezultate të dukshme sidomos në studimin e kompozitave pronësore, dëshirore dhe urdhërore.<sup>37</sup> Krejt i ri është edhe vështrimi stilistik në shpjegimin e modeleve e të mundësive të formimit të fjalëve të prejardhura. Një dallim në vijat kryesore është bërë midis formimeve në gjuhën e shkruar dhe në gjuhën e gjallë të popullit. Këtë dallim e gjejmë të zbatuar në të gjitha rastet tek «Parashtesat e gjuhës shqipe» dhe «Prapashtesat e gjuhës shqipe». Nga ana tjetër, ngjyrimet stilistike dhe përkatësia stilistike e fjalës janë parë nga afër në ndikimin e tyre mbi fjalëformimin, në veçanti për kompozitat.<sup>38</sup>

Thellimi në strukturën e fjalës shqipe pati si pasojë, që edhe në përpunimin e drejtshkrimit të shqipes të formulohet qartë edhe një parim tjetër i përgjithshëm: «Parimi fonetik i drejtshkrimit të shqipes plotësohet edhe nga parimi morfologjik, d.m.th. nga synimi që të ruhen sa më të qarta në shkrim struktura dhe njësia e trajtave, si edhe struktura e formimit të fjalëve».<sup>39</sup>

35) K. Cipo, *Rreth disa kompozitave*, «Buletin i Institutit të Shkencave», 1948, nr. 1, f. 51-54; K. Cipo, *Gramatika shqipe*, T. 1949, f. 43-44; A. Xhuvani, *Kompozitat*, «Studime gjuhësore», T. 1956, f. 187-192.

36) Shih shën. 11.

37) Shih sidomos: A. Kostallari *Mbi disa veçori...*, dhe *Kompozitat dëshirore dhe urdhërore...*

38) Shih sidomos A. Kostallari: *Kompozitat ekzocentrike...*, f. 26-31.

39) *Rregullat e drejtshkrimit të shqipes (projekt)*, T. 1967, f. 7.

Përgjithësimi teorik edhe në këtë fushë ka gjetur një mbështetje të shëndoshë në grumbullimin sistematik të materialit faktik. Dy veprat themelore në këtë drejtim, «Parashtesat e gjuhës shqipe» dhe «Prapashtesat e gjuhës shqipe», japin jo vetëm një inventar të pasur, por edhe tregojnë funksionet e morfemave, përmbajnë një varg vërejtjesh mbi prejardhjen e tyre, sjellin rezultatet e studimeve etimologjike e krahasuese, të cilat kanë vlerë edhe për ballkanistikën në përgjithësi. Autorët kanë përdorur një letërsi shumë të gjërë dhe kanë sjellë materiale të reja, duke vënë në dukje pasurinë e mjeteve fjalëformuese të shqipes.

Punimet përgjithësuere për fjalëformimin e shqipes ende mungojnë, me përjashtim të kursit special të leksioneve të A. Kostallarit «Formimi i fjalëve në gjuhën e sotme shqipe». Megjithatë studimet e veçanta për tipat e ndryshëm të fjalëve të prejardhura, bashkë me kontributet që janë dhënë në punimet e tjera për leksikologjinë e gramatikën kanë krijuar tashmë bazën e nevojshme për të ecur më tej edhe në këtë drejtim.

\* \* \*

Duke i vështruar në tërësinë e tyre rezultatet e leksikologjisë shqipe e të fjalëformimit ashtu siç na paraqiten në këtë përvjetor të shënuar, mund të themi me bindje se ato janë duke ecur në një rrugë që ngjitet. Ato janë tashmë në gjendje të shtrojnë dhe të zgjidhin detyra më të vështira për të kaluar në përgjithësi më të mëdha, që të nxjerrin ligjshmëritë e përgjithshme të zhvillimit të leksikut si sistem; njëkohësisht mund t'i japin një ndihmë të vlefshme praktikës në shumë drejtime. Një shtytje e fuqishme do jetë në vitet e ardhshme botimi i fjalorit të ri shpjegues, në procesin e hartimit të të cilit teoria i çel rrugën praktikës dhe materiali i pasur konkret e praktika e shtyjnë teorinë drejt arritjeve më të gjëra, më të mbështetura, më të shoshitura e të provuara nga përvoja.

## R é s u m é

### PRINCIPAUX RESULTATS DANS L'ETUDE DU LEXIQUE ET DE LA FORMATION DES MOTS DANS LA LANGUE ALBANAISE APRES LA LIBERATION

*Il serait difficile de parler avant la libération du pays d'une lexicologie albanaise, en tant que discipline scientifique à part, ayant une théorie traitée à plusieurs égards. La linguistique étrangère, s'amorçant surtout aux exigences des études comparatives historiques a débattu longuement les problèmes du lexique et de la sémantique presque exclusivement sous le prisme historico-étymologique. Le patrimoine dans la lexicologie et sémasiologie historique est assez vaste, pourtant il résulte actuellement avec une suite de lacunes, notamment en raison de la méthodologie employée.*

*Cela présent, on peut dire que la lexicologie albanaise, comme la branche qui a pour tâche fondamentale la description scientifique du système lexical de l'albanais et l'éluciation des régularités historiques de son développement, fut isolée dans notre linguistique après la libération*

du pays, et elle a avancé dans son chemin au point d'obtenir plusieurs acquisitions qui méritent d'être mises en vue.

Dans les premières années au lendemain de la libération, les tâches les plus urgentes furent posées à la lexicographie. Les exigences à résoudre ces tâches durant l'élaboration du dictionnaire explicatif, ainsi que les deux amples discussions qui eurent lieu à cette époque, ont formé une incitation importante à ranimer la pensée aussi dans le domaine de la lexicologie.

Le Dictionnaire de l'albanais, paru en 1954, représentait une oeuvre de valeur pour la lexicologie, du fait qu'il sert de base pour la description du système et l'étude synthétisante du lexique. Le dictionnaire représentait dans le même temps aussi un jalon évident pour connaître jusqu'à quel point avait marché la lexicologie et la lexicographie albanaises. C'est pourquoi, aussi les nombreux articles et comptes-rendus sur lui le considéraient non point comme un travail à part, mais comme une étape dans la solution d'une grande tâche importante. A. Kostallari, dans son article: Sur le chemin de l'élaboration du dictionnaire normatif de l'albanais contemporain, tout en faisant un examen du matériel du dictionnaire, formulait aussi les tâches qui résultaient pour un proche avenir.

Le premier résultat important fut ainsi le passage de l'attention de l'aspect historique à l'étude du lexique contemporain de la langue albanaise vivante. Une suite d'articles, d'études et de travaux virent le jour pendant cette période, c'est pourquoi nous croyons nécessaire de nous arrêter à leurs concepts fondamentaux.

A l'heure que nous sommes, est déjà surmonté le traitement des unités particulières du dictionnaire, et les linguistes considèrent le trésor des mots de l'albanais comme un système, naturellement assez mobile et compliqué, mais un tel examen a permis de saisir mieux ses particularités. L'horizon s'est élargi et de nouveaux domaines et matériaux ont été inclus dans l'étude. Cette modification quantitative a été associée par un approfondissement du traitement, de sorte qu'on a élaboré aussi une nouvelle conception sur la richesse du lexique de l'albanais.

Le mot albanais a été entrepris dans son existence vivante, dans toute la variété d'usages, ce qui a influé également sur les recherches et le glane pratique du lexique de la vive bouche du peuple. Notre lexicologie actuelle a montré que la formation des mots par la souche de la langue maternelle constitue la voie principale de l'enrichissement du lexique, mais importantes sont aussi les autres voies intérieures.

Les mots et les couches du lexique ont été traitées en rapport avec les conditions historico-sociales, qui ont déterminé leurs modifications et leurs développements. Ont été observées d'une manière toute particulière les modifications sensibles au lexique, intervenues après la révolution populaire, par suite des grandes transformations qu'il a entraînées dans toute la vie du pays.

Devant le linguiste continue de rester la tâche permanente de faire ressortir les particularités du mot albanais, de sa spécifique. Dans la solution de cette tâche, l'étude n'est pas entrée dans le cercle vicieux d'un examen de pure forme, mais la forme a été entrevue toujours en liens étroits avec le contenu. C'est pourquoi la sémantique a une place remarquable dans tous les travaux. Un résultat valable est l'affranchissement de l'observation du sens du mot, de la façon que l'exigeaient les dictionnaires antérieurs, au concept sur le mot en tant que structure sémantique. C'est ainsi que s'achemina le traitement de la polysémie dans la langue

albanaise contemporaine. Pour ce qui est des problèmes de la polysémie, ont été débattues aussi les questions de l'homonymie lexicale dans les articles de Xh. Lloshi.

En considérant le lexique comme un système, la lexicologie albanaise n'a pas laissé en arrière-main le mot en tant qu'unité fondamentale, mais tout au contraire, elle l'a mis au centre de l'attention et l'a considéré sous tous ses liens et aspects. A plusieurs égards, notre linguistique s'est rapprochée, en général, au traitement théorique de la notion sur le mot albanais en tant qu'unité.

Du nombre des groupements sémantiques des mots, ont été débattus plus amplement les antonymes dans plusieurs articles de M. Samara. Dans les différents travaux, il y a plusieurs observations sur la synonymie. Néanmoins, l'absence de l'étude à tout égard de la synonymie représente un creux sensible.

J. Thomaj a entrepris une suite de travaux sur les compositions phraséologiques en albanais, en montrant les traits fondamentaux, les rapports internes des membres et leur structure, et aboutissant à une codification générale.

Le traitement de la phraséologie, à côté des autres questions, rendra possible de construire une théorie cohérente sur les liens sémantiques des mots dans le parler, sur la syntagmatique sémantique.

Les principes fondamentaux pour l'élaboration du Dictionnaire de l'albanais contemporain, qui viennent de paraître dernièrement, représentent un travail où notre lexicologie et notre lexicographie sont fondues en une théorie unique, qui non seulement résume les résultats les plus importants acquis après la libération, mais les porte encore plus loin.

On peut affirmer que dans le traitement des problèmes de la stylistique linguistique, la lexicologie a marché plus loin que les autres branches de notre linguistique.

Dans la période après la libération, aussi la lexicologie historique a atteint de nouveaux résultats. Ont été mis en circulation scientifique de nouveaux matériaux, et ont été obtenues d'autres synthèses dans le regard d'ensemble des couches lexicales au point de vue historico-étymologique, ainsi qu'ont été étudiées plus profondément les productions des auteurs singuliers.

Un grand travail d'investigation dans le domaine de l'histoire et de l'étymologie des mots a été fait par E. Çabej, dont le couronnement est représenté par ses Etudes d'étymologie albanaise. Ainsi, ont été restitués à l'albanais plusieurs mots et a été fait ressortir aussi le rôle emprunteur de l'albanais.

Désormais, il devient possible d'étudier bien mieux le lexique des siècles passés, en introduisant aussi dans l'histoire la notion du système lexical et différer la direction pour passer de l'histoire à l'état actuel, rattacher la diachronie à la synchronie.

Nous pouvons faire ressortir deux particularités positives de tous les travaux dans cette branche. Premièrement, les questions ont été traitées en mettant en circulation un matériel de faits nouveaux et riches; deuxièmement, a été évalué l'apanage à partir de nouvelles positions, en conservant ainsi aussi la continuité dans les solutions qui ont résisté à la critique.

La lexicologie a marché en liens étroits avec la formation des mots.

Avant la libération, aussi dans le domaine des études sur la formation des mots on visait plutôt à satisfaire les exigences de l'histoire de la

langue, c'est pourquoi il prédominait l'analyse étymologique. A côté de cette dernière marchait aussi l'analyse grammaticale. Le principal résultat dans ce domaine, après la libération, est l'affranchissement de la formation des mots comme une discipline à part, avec son objet, sa méthode et ses tâches.

Une synthèse et un bilan critique des solutions obtenues jusqu'à ce jour, conjointement à des nouvelles et nombreuses contributions, ont été réalisées dans les traités *Les suffixes de l'albanais* et *Les préfixes de l'albanais*, d'A. Xhuvani et E. Çabej.

Au centre de l'attention a été mise l'analyse de formation du mot, ce qui représente l'objet fondamental de cette discipline. On a passé ainsi du morcellement mécanique du mot à l'idée centrale sur la structure du mot, comme un système de morphèmes liés et interdépendants, qui forment le mot comme un tout lexico-grammatical. Par là, fut ouvert le chemin à découvrir les particularités structurelles du mot albanais. On a distingué quelques-uns des types les plus productifs et les plus vivants dans l'albanais contemporain.

Des questions particulières, une mention ont les études sur les composés de l'albanais, faites par A. Kostallari. Celles-ci ont confirmé la vivacité aussi de cette voie pour la formation des mots en albanais, ce qui avait été tout simplement dénié par les linguistes antérieurs.

L'analyse structurelle a été achevée, durant l'étude, par l'analyse des particularités sémantiques du mot, ce qui a concouru à l'analyse juste de leur contenu et à l'élucidation des types qu'ils représentent. Tout à fait nouvelle est l'observation stylistique dans l'explication des modèles et des possibilités de la formation des mots dérivés.

La synthèse théorique aussi dans ce domaine a trouvé un appui solide dans l'amas systématique du matériel des faits. Désormais a été formée la base nécessaire à marcher de l'avant aussi dans cette direction.

La lexicologie albanaise et la formation des mots sont, à l'heure que nous sommes, en état de poser et de résoudre des tâches encore plus difficiles, de passer à des synthèses plus amples, faire ressortir les régularités générales du développement du lexique en tant que système et, dans le même temps, elles peuvent fournir un concours valable à la pratique et à l'école à plusieurs égards.

